



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:921048

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05717734

KA.nr.529/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “Mercom Company” me NUI 810298548 dhe seli në rrugën Fehmi Agani, hyrja 96, kati 1, nr.1 në Prishtinë, të cilin sipas prokurës e përfaqësojnë avokatët Xhevat Krasniqi dhe Ilir Nikqi me seli në rrugën Dëshmorët e Kombit nr. 58 në Prishtinë, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në rrugën Migjeni p.nr. në Prishtinë, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 15.04.2024 në të cilën morën pjesë të dy palët, më 2 maj 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Aprovohet pjesërisht kërkesëpadia e paditësit “Mercom Company” me NUI 810298548 kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, anulohen pikat I., III., IV. dhe V të dispozitivit të vendimit PSH.nr.208/16 nr. 210/16 të datës 27.07.2016 të së paditurit, çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te i padituri, ashtu që në afat prej tridhjetë (30) ditëve në ri procedurë të nxjerrë akti të ri administrativ lidhur me këtë pikat e anuluar sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim.
- II. Hedhet poshtë padia e paditësit “Mercom Company” me NUI 810298548 kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, me të cilin e ka kërkuar anulimin e pikës II. të dispozitivit të vendimit PSH.nr.208/16 nr. 210/16 të datës 27.07.2016 të së paditurit.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 18.08.2016 e ka iniciuar konfliktin administrativ me kërkesë për anulimin e tërësishëm të vendimit PSH.nr.208/16 nr. 210/16 i datës 27.07.2016 i të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë dhe kthimin e çështjes në rivendosje.
2. Paditësi në padi dhe gjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka pretenduar se vendimi i goditur për hedhjen poshtë të ankesës është i kundërligjshëm për arsye se ai fillimisht ka qenë fitues i këtij tenderi, mirëpo pas kthimit në rivlerësim është shpallur fitues një operator tjetër, e me këtë atij i cenohet e drejta e tij dhe si rezultat ka pasur dhe ka interes juridik për ankesën e tij. Sipas tij, këtë gjë ia lejon edhe neni i 13 i LPPA-së lidhur me nenin 4.1.26 të LPP-së.
3. I Padituri me përgjigjen në padi si dhe gjatë seancës së shqyrtimit kryesor e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e Paditësit dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj atë. Ka deklaruar se gjatë shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor konstatoi se ankesa e Paditësit duhet të hedhet si e palejuar, për faktin se nuk ka dëshmuar se ai është i përgjegjshëm dhe se në të ardhmen mund të jetë nënshkruar i kësaj kontrate, pra nuk ka dëshmuar se ka interes juridik material sipas nenit 4.1.26 të LPP-së. Sipas tij, Paditësi lidhur me këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka atributin e palës së interesuar, konform nenit të lartcekur, pra ai gjithashtu nuk ka pasur dhe nuk pritet të pësoj dëme eventuale nga vendimi i autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit. Ka shtuar se, edhe me rastin e parashtrimit të ankesës paneli konstaton dhe vlerëson se Paditësi nuk ka dëshmuar se është palë e interesuar dhe nuk ka mundur të dëshmojë se mund t'i shkaktohet dëm material konform nenit 111 par.1 pika 1.5 dhe 1.8 i LPP-së për vet faktin se Paditësi është i papërgjegjshëm. Më tutje ka argumentuar se vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe në këtë rast janë respektuar dispozitat e nenit 61 të LPP-së, për faktin se autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarime lidhur me çmimin e ofertave të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit dhe njëherit është e bindur me përgjigje të dhëna. Lidhur me pretendimin e Paditësit në raport me nenin 7 të LPP-së paneli pas analizimit të dokumentacionit nuk ka vërejtur se ka diskriminim.

II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

4. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e prova. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor me propozim të Paditësit, të cilin nuk e kundërshtori i Padituri, u lexua procesverbali i seancës së shqyrtimit kryesor të datës 19.03.2019 në lëndën A.nr.1233/16 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, gjatë së cilës ishin administruar provat si në vijim: vendimi PSH.nr.208, 210/2016 i datës 29.07.2016; vendimi nr. 75/16, 77/16, 80/16 i datës 23.05.2016, njoftimi për dhënien e kontratës i datës 23.03.2016; ankesa e datës 08.07.2016; raporti i vlerësimit të tenderëve; raporti i ri vlersimit të tenderëve; letra standarte për sqarimin e tenderit e datës 18.03.2016, përgjigja në padia e datës 20.11.2018, kronologjia e datës 22.07.2016, raporti i ekspertizës i datës 18.04.2016, oferta e operatorit ankues dhe operatorit fitues, kapaciteti teknik dhe profesional, kërkesa 1, 3 dhe 4, si dhe dosja e tenderit.
5. Gjykata pas analizimit të provat të cekura më lartë në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe duke i zbatuar rregullat e të provuarit nga neni 322 i LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së e konstatoi gjendjen faktike të përshkruar më poshtë.
6. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si autoritet kontraktues (këtu e tutje Autoriteti) më 13.11.2015 ka iniciuar aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i palestrës sportive në Komunën e Dragashit-Rindërtimi i dytë” me numër të prokurimit 207/15/042/511, në të cilën kishte paraqitur ofertë edhe Paditësi.
7. Më 23.03.2016 autoriteti kontraktues kishte dhënë njoftimin për dhënien e kontratës, përmes të cilit Paditësi ishte shpallur operator ekonomik i suksesshëm.
8. I Padituri përmes vendimit PSH.nr. 75/16; 77/16 dhe 80/16 të datës 23.05.2016 duke i aprovuar ankesat operatorëve tjerë ekonomik e anuloi vendimin e Autoritetit për dhënien e kontratës dhe e ktheu lëndën në rivendosje.
9. Më 30.06.2016 Autoriteti kishte publikuar letrën standarte për tender, sipas të cilës kishte njoftuar se kontrata në atë aktivitet të prokurimit i është dhënë një operatori tjetër ekonomik.
10. Ndaj vendimit të cekur më lartë Paditësi kishte parashtruar ankesë, të cilën i Padituri përmes vendimit të godituri PSH.nr. 208/16, nr. 210/16 të datës 27.07.2016 e kishte hedhur poshtë. Konkretisht, i padituri me vendimin e goditur në pikën I. e ka hedhur

poshtë ankesën e Paditësit, në pikën II. e ka refuzuar anesën e operatorit ekonomik Albi Compnay, në pikën III. e ka vërtetuar vendimin për dhënien e kontratës, në pikën IV ka përcaktuar se konfiskohet shuma e deponuar në emër të ankesës së operatorit ekonomik Albi Company, ndërsa shuma e deponuar nga Paditësi duhet t'i kthehet, si dhe në pikën V. e ka obliguar Paditësin që të parashtrij kërkesë për kthimin e mjeteve të deponuara në emër të ankesës. I Padituri në vendimin e goditur kishte arsyetuar se Paditësi si ankues nuk ka interes juridik material sipas nenit 4.1.26 të LPP-së, rrjedhimisht në bazë të nenit 111 par.1 pika 1.5 dhe 1.8 i LPP-së e ka hedhur poshtë ankesën.

11. Provat tjera të administruara nga gjykata nuk provuar ndonjë fakt tjerët relevant lidhur me këtë çështje, prandaj gjykata vendosi të mos lëshohet në elaborimin e hollësishëm të tyre.

III. Vlerësimi meritor i rastit

12. Gjykata i shqyrtoi të gjitha pretendimet e Paditësit dhe të Paditurit, gjendjen faktike të konstatuar më lartë si dhe dispozitat juridike të cekura më poshtë, si dhe duke i marrë parasysh vërejtjet e gjykatës më të lartë, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.
13. Në rend të parë gjykata sqaron se çështja është në rivendosje sipas aktvendimit K.Dh.Sh.II.nr. 658/22 të datës 05.10.2023 të Gjykatë Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Dytë, me të cilin e ka prish aktgjykimin A.nr.1233/16 të datës 02.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata e instancës së dytë kishte udhëzuar që në ri procedurës gjykata e shkallës së parë, në veçanti duhet që të vlerësojë ligjshmërinë e aktit të goditur duke shqyrtuar nëse e Paditura e ka ndjekur drejtë procedurën me rastin e vendosjes që ta hedh poshtë ankesën e Paditësit, më pas duhet të vlerësojë bazën juridike nëse e Paditua ka pasur bazë ligjore për të nxjerrë një vendimi të tillë dhe merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm.
14. Gjykata rikujton se në çështjen konkrete objekt ankimi para të Paditur ishte vendimi i Autoritetit për dhënien e kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i palestrës sportive në Komunën e Dragashit – Ri tenderimi i Dytë” me nr. prok.207/15/042/511. Me këtë vendim Paditësi ishte shpallur tenderues i pasuksesshëm në ritenderimin e dytë, e i cili paraprakisht në procedurën e tenderimit të parë ishte shpallur si ofertues i suksesshëm. Andaj, fakti se në këtë procedurë të prokurimit

Paditësi fillimisht ishte shpallur operator ekonomik fitues, kurse në ritenderimin e dytë ishte shpallur i pasuksesshëm, kjo gjykatë vlerëson se i Paditësi ka pasur të drejtë ligjore për të parashtruar ankesë në Panelin Shqyrtues të Prokurimit.

15. Së këndejmi, vendimi kontestues i të Paditurit që ta hedh poshtë si të palejuar ankesën e Paditësit është i kundërligjshëm dhe nuk bazohet në normat juridike të parapara me LPP dhe LPPA. Sipas kësaj gjykate, referenca që e Paditura në cilësi të organit administrativ i bën dispozitës së nenit 4.1.26 të LPP-së është e pabazuar dhe nuk rregullon legjitimitetin procedural të palës në procedurën administrative. Përkundrazi, kjo gjykatë vlerëson se me faktin që Paditësi ka qenë fillimisht ofertues i suksesshëm e më pas është shpallur operator ekonomik i pasuksesshëm i jep atij të drejtë legjitime që konform nenit 4.1.26 të LPP-së të parashtrorë ankesë si palë e interesuar në procedurë. Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se e Paditura gabimisht dhe në mënyrë të kundërligjshme e ka hedhur poshtë ankesën e paditësit, ndërsa është dashur që vendos në merita për ankesën e Paditësit.
16. Po ashtu referimi në dispozitën e nenit 111 par.1 pika 1.8 të LPP-së është referencë joadekuate lidhur me rastin konkret, pasi ajo ka të bëjë me përmbajtjen e ankesës dhe i referohet dëmit të supozuar që mund t'i shkaktohet Paditësit.
17. Lidhur me këtë bazë ligjore, gjykata vlerëson se Paditësi të drejtën e tij legjitime e mbështet në eliminimin nga procesi tenderues. Në këtë drejtim, nëse organi administrativ ka supozuar se Paditësi eventualisht ka qenë i pasuksesshëm në përmbajtjen e çështjes, atëherë është dashur të vendos meritorisht lidhur me rastin.
18. Gjykata gjithashtu vlerëson se në një procedurë administrative, në të cilën pala ka pasur statusin e palës së interesuar, e Paditura nuk ka mundur që përmes vendimit procedural duke e hedh poshtë ankesën dhe t'ia mohojë të drejtën për një proces të rregullt brenda organit administrativ, rrjedhimisht Paditësit nuk i është dhënë mundësia për të shqyrtuar çështjen në procedurë administrative.
19. Për këto arsye gjykata gjeti se pikat I, III, IV dhe V e vendimit të goditur, të cilat janë nxjerr në kundërshtim me LPP-në rrjedhimisht duhet të anulohet. Gjykata rikujton se Paditësi kishte kërkuar që gjykata ta kthej në rivendosje çështjen e administrativ, rrjedhimisht gjykata ishte e kufizuar të gjykoj brenda kufijve të kërkesëpadisë, siç përcakton nenit 44 para. 1 i LKA-së.

20. Në anën tjetër, gjykata e vlerësoi padinë e Paditësit edhe në raport me pikën II. të dispozitivit të vendimit të goditur dhe erdhi në përfundim se ajo është e palejuar.
21. Në këtë drejtim gjykata gjeti se pika II. e vendimit të goditur i referohet ankesës së Albi Compnay nga Rahoveci, ndërsa nuk i prek të drejtat e Paditësit, e as nuk e ngarkon atë me detyrime. Gjykata gjithashtu vërejtë se Paditësi në asnjë moment gjatë procedurës nuk ka deklaruar se me padi nuk kërkohet shqyrtimi i ligjshmërisë lidhur me pikën II. të dispozitivit të vendimit të goditur.
22. Duke qenë kështu, gjykata vlerëson se Paditësi nuk ka të drejtë të kërkoj anulimin e një akti administrativ në pjesën, e cila nuk i cenon të drejtat e tij e as nuk i cakton atij ndonjë detyrim. Këtë qëndrim gjykata e mbështet në nenin 10 para. 1 të LKA-së, sipas të cilit *“Të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik si dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejt apo interes ligjor”*, si dhe nenin 34 para. 1 nënpara. 3 të LKA-së, i cili ka përcaktuar se *“Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se: (...) është e qartë se me aktin administrativ, që kontestohet me padi, nuk preken të drejtat e paditësit ose interesi i tij i drejtpërdrejtë i bazuar në ligj”*
23. Prandaj, gjykata vlerësoi se është e qartë që me pikën II. të dispozitivit të goditur nuk preken interesat e Paditësit e as nuk caktohet ndonjë detyrim në raport me të, rrjedhimisht në bazë të nenit 34 para. 1 nënpara. 3 të LKA-së e hodhi poshtë padinë lidhur me këtë pjesë

IV. Udhëzimet për organin administrativ në ri procedurë.

24. I Padituri në ri procedurë duhet ta rivlerësoj ankesën e Paditësit dhe të nxjerrë akt administrativ të ri në përputhje me dispozitat LPP-së dhe t’ia dërgoj Paditësit. Konkretisht, i Padituri ankesën e Paditësit si operator ekonomik ankues duhet që ta vlerësoj në mënyrë meritore, që nënkupton se vendimi i ri i të Paditurit duhet të jetë aprovues ose refuzues, varësisht nga të gjeturat e të Paditurit, por assesi nuk mundet ta hedh poshtë ankesën e Paditësit.
25. Gjykata rikujton se i Padituri me rastin e nxjerrjes së aktit të ri administrativ është i obliguar nga pikëpamja juridike e gjykatës, si dhe nga vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurën, siç e ka paraparë neni 65 i LKA-së. Gjykata sidomos rikujton se nxjerrja e

vendimit të ri në kundërshtim me vërejtjet e gjykatës është bazë për fillimin e konfliktit administrativ sipas nenit 16 para. 1 nënpara. 5 i LKA-së.

26. Për arsyet e cekura më lartë, duke u bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës
Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative
KA.nr.529/2022

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.